



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3230 Prot.,

Lezhë, me 10.03.2025

URDHËR

Nr. 157 Datë 10.03.2025

**“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR NË SHËRBIMIN CIVIL, NË  
BASHKINË LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 , nenit 9 pika 1.1 gërma “b” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 59 të ligjit nr.152/2013” Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Kreut I pika 3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Krijimin e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Civil, në Bashkinë Lezhë me përbërje si më poshtë:

1. Z. Reinis Çela	Sekretar i Përgjithshëm	Kryetar
2. Znj. Jetmira Leka	Drejtor i BNP	Anëtar
3. Znj. Liljana Dushkaj	Nëpunësi më i vjetër civil	Anëtar
4. Eprori direkt i nëpunësit për të cilën ka nisur ecuria disiplinore		Anëtar
5. Nëpunësi civil më i vjetër i njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore		Anëtar

2. Komisioni disiplinor shqyrton dhe heton të gjitha faktet dhe vlerëson rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, në përfundim të hetimit administrativ.

3. Një kopje e këtij urdhëri t’i njoftohet anëtarëve të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Civil, në Bashkinë Lezhë.

4. Për Zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen anëtarët e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Civil dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

